

Emri i lëndës	<b>Protokolli diplomatik</b>	Shifra	<b>303</b>
Bartësi i lëndës		Viti	<b>3</b>
Programi i studimit	Politikë Ndërkombëtare dhe Diplomaci-Bachelor	Statusi i lëndës	<b><u>Obliqese</u></b> zgjedhore
Qëllimi i lëndës	<p><i>Zhvillimi i lëndës “<b>Protokolli diplomatik dhe protokollin zyrtar</b>” ka si qëllim të pajisë studentët e Kolegjit Universitar Victory të Prishtinës me një material bazë të nevojshëm diplomatiko-protokollar dhe protokollaro-zyrtar, t’u japë atyre njohuritë më të domosdoshme të zhvillimit të diplomacisë botërore, të lidhur ngushtë me parimet universale dhe të veçanta të protokollit zyrtar dhe ceremonialit diplomatik, të natyrës komplekse të protokollit, rolit të tij të pazvendësueshëm dhe vendimtar në përgatitjen e aktiviteteve të mëdha si dhe zhvillimit të tij nga kohët më të lashta deri në ditët tona. Pjesë e rëndësishme e kësaj lënde do të jenë edhe praktikatat e përgjithshme diplomatiko-protokollare të pasuruara ose të përshtatura në vende të caktuara, të shoqëruar me elementët më të rëndësishëm të protokollit zyrtar në një lidhje të tyre organike dhe të pashkëputshme sidomos në planin praktik. Gjatë zhvillimit të kësaj lënde do t’i kushtohet kujdes dhe vëmendje protokollit zyrtar të Shqipërisë, zhvillimeve të tij në funksion të ndryshimeve historike dhe politike të brendshme, të shoqëruar kjo me pjesët më të rëndësishme të protokollit zyrtar shtetëror dhe praktikatat e ndryshme të tij.</i></p> <p><i>Në kuadër të protokollit dhe respektimit të normave të tij do të jepen njohuri mbi “protokollin diplomatik”, të domosdoshme për t’u njohur por edhe zbatuar në praktike. Trajtimi i rolit të pazvendësueshëm të protokollit diplomatik në tërësinë, zhvillimin apo përshtatjen me marrëdhëniet diplomatike midis shteteve, midis institucioneve deri edhe midis personave të veshur me imunitet diplomatik do t’u shërbejë studenteve jo vetëm të kuptojnë më lehtë thelbin e qëndrimeve zyrtare në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare por të jenë më të ndjeshëm me profesionin, me shoqërinë, në shërbim të formimit të personalitetit dhe të paraqitjes dinjitoze në situata dhe komunikime të ndryshme të jetës së përditshme.</i></p> <p><i>Ky cikël ligjëratash do t’u shërbejë studentëve jo vetëm në aspektin akademik dhe teorik por sidomos në atë praktik: njohja sa më e mirë e kësaj lënde do t’u shërbejë atyre të përballen bindshëm gjatë thellimit autodidakt apo të drejtuar të njohurive të tyre në studimet e mëtejshme të tyre ashtu edhe në sfidat e konkurimit të tyre në dikastere të rëndësishme qendrore publike apo private si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</i></p> <p><i>Të gjitha temat do të shoqërohen me shembuj historike, me fakte dhe ngjarje historike të njohura dhe të reja në funksion të shpërndarjes sa më të suksesshme të mësimdhënies dhe me bibliografinë përkatëse për orët praktike në kontroll të njohurive të studentëve.</i></p>		

Përmbajtja e lëndës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ceremoniali dhe diplomacia</li> <li>• Profesioni i diplomatit.</li> <li>• Protokollit dhe Etika.</li> <li>• Rregulla të Përgjithshme të Protokollit Zyrtar.</li> <li>• Titujt e Ndryshëm dhe Emërtimet.</li> <li>• Protokollit dhe Ceremoniali zyrtar</li> <li>• Ceremoniali Diplomatik</li> <li>• Radha e përparësisë zyrtare ne Republikën e Shqipërisë</li> <li>• Ceremoniali zyrtar i Autoriteteve më të larta të Shtetit</li> <li>• Simbolet e Republikës</li> <li>• Heraldika</li> <li>• Ceremoni dhe Autoritete</li> <li>• Vizita dhe Takime</li> <li>• Ftesa dhe përgjigje</li> <li>• Misionet diplomatike</li> </ul>		
Format e zhvillimit të mësimin	<b>Ligjeratat</b>	<b>Seminaret dhe punëtoritë</b>	<b>Ushtrimet</b>
	<b>Konsultimet</b>	Multimedial	Interneti
	Detyrat e pavarura	Punim mendor	Demonstrimet
	Laboratori (praktikumi)	Mësimi në distancë	
Mënyra e vlerësimit të diturisë	<p><b>FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT</b></p> <p><b>FREKUENTIMI:</b> 70% i pranisë në ushtrime e domosdoshme.  10 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë ligjëratave apo ushtrimeve.</p> <p><b>KONTROLLI I VAZHDUESHËM:</b>  Gjatë zhvillimit të ushtrimeve kontrolli duhet të jetë i vazhdueshëm.</p> <p><b>DETYRA E KURSIT:</b>  Detyrë kursi ose seminari fakultativ. Konspekt i një eseje nga 15- 20 faqe format A4, Times NewRoman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)  30 % e notës përfundimtare</p> <p><b>KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:</b>  Testi përfundimtar në javën e fundit të kursit. ( me shkrim dhe (ose) me gojë, (fakultative).  90 % e notës përfundimtare</p>		
Literatura obliguese	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konventa e Vienes per Marredheniet Diplomatike” 18 prill 1961</li> <li>• ose “Vienna Convention on Diplomatic Relations”on 18 April 1961</li> <li>• Ligji Nr. 9095, Dt.3.07.2003 për “Shërbimin me jashtë të Republikës së Shqipërisë</li> <li>• Ceremoniali zyrtar i Republikës se Shqipërisë” (VKM nr.229, 23 prill,</li> </ul>		

	2004)		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kissinger, Henry. Diplomacia, Shtepia botuese e Lidhjes se Shkrimtareve, Tirane 1999</li> <li>• Mitrojorgji, Nasi. Protokolli, Njohuri dhe aspekte te protokollit zyrtar, Botimet Toema, Tiranë 2007</li> </ul>		
Literatura shtesë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Maxhuni, Fadil. Protokolli Diplomatik (praktikum), Shtëpia Botuese Era, Prishtinë 2008</li> <li>• Serres, Jean. Manuel Pratique de Protocole, Edition de la Bievre, Courbevoie, France 1992</li> <li>• Mc Caffree (Mary Jane) and Innis (Pauline), Protocol, the complete handbook of diplomatic, official and social usage. Washington D.C. Devon publishing company Inc., 1985</li> </ul>		
Vlerësime me pika krediti		Semestri dimëror	Semestri veror
		5	0
Mënyra e provimit	Provim me shkrim, provim me gojë, punim seminarik		
Përfitimi i kredive për studentë të rregullt	<ul style="list-style-type: none"> <li>• ligjëratat</li> <li>• ushtrimet</li> <li>• përgatitja e seminarit</li> <li>• përgatitja e studentëve në provim</li> </ul>		
Mënyra e përcjelljes së kualitetit dhe suksesit si dhe aplikimi i tij	<p>Përcjellja e kualitetit dhe suksesit të përpunimit të lëndës do të kryhet në mënyrë kontinuele dhe atë në disa nivele me anë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përpunimit statistikor dhe analizës së rezultatit të provimeve (verifikimi i lakores Gaussov-it- ndarja normale e suksesit, krahasimit dhe përcjelljes së rezultatit në provime të gjeneratave të ndryshme, analiza e të kuptuarit të disa moduleve (metodave), pyetjeve në provime etj.),</li> <li>• zhvillimit të anketave në mesin e studentëve,</li> <li>• evalvimit dhe vetevaluimit të profesorëve,</li> <li>• pyetësorit të vazhdueshëm (propozime për përmirësim) të paraqitur në web faqe (për studentë dhe për personelin arsimor),</li> <li>• rezultateve të arritura, shkallës së të kuptuarit dhe diturisë gjatë punimit të seminarit (studentët të cilët zgjedhin punimin e seminarit nga kjo lëndë),</li> <li>• rezultateve të arritura dhe shkallës së njohurisë gjatë punimit dhe mbrojtjes së punimit të diplomës (studentëve të cilët zgjedhin punimin e diplomës nga kjo lëndë)</li> <li>• analizës së raportit kualitativ si dhe</li> <li>• informatave kthyesë nga ana e studentëve të cilët tashmë kanë diplomuar, për shfrytëzimin e përmbajtjes së kësaj lënde në kryerjen e punëve me të cilat merren.</li> </ul>		